DHOMA E BIZNESIT
TË DIASPORËS SHQIPTARE

AIC
Associazione Italiana Coltivatori

IOM
UN MIGRATION

Angazhimi i Diasporës në transferimin e njohurive bujqësore në Shqipëri

KONFERENCË

"Përfshirja sociale në zhvillimin rural"

E mërkurë, 29 shtator 2021

09:00 – 13:30

Salla Carlsberg , kati 2, Hotel Xheko Imperial
Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë



Kontakt: info@adbc.al

“Përfshirja sociale në zhvillimin rural”

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare (DHBD), në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve Italianë (AIC) dhe me mbështetjen e IOM Albania përfshirë në programin “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim, organizoi aktivitetin përmbyllës në kuadër të projektit “Angazhimi i Diasporës në Transferimin e Njohurive Bujqësore në Shqipëri” të fokusuar në trajtimin e çështjeve të përfshirjes sociale të zonave rurale.



Kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës, Ardian Lekaj theksoi se ky është projekti i parë i zbatuar nga Dhoma në fushën e bujqësisë, por mjaft i suksesshëm: “Jemi krenarë për punën e bërë nga Dhoma e Biznesit të Diasporës në partneritet me Shoqatën e Kultivuese Italianë, si edhe vlerësojmë, pa diskutim, si shume të rëndësishme mbështetjen e IOM Albania.

Projekti ishte i shkurtër në afat kohor, por rezultatet ishin shumë të mira. Dhoma e Biznesit të Diasporës e krijuar para dy vitesh e ka në fokus të saj saj bujqësinë pasi është një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomiko-social të vendit.

Pjesëtarë të Diasporës Shqiptare kudo që ndodhen në botë merren me bujqësi dhe janë të lidhur ngushtë me këtë sektor të ekonomisë. Dhoma do vazhdojë të ndërtojë ura të reja bashkëpunimi dhe përvojat e marra në Diasporë do ti sjellim në vendin tonë amë. Një formë shumë e mirë është nxitja e të rinjve për t’u marrë me bujqësi, pasi kjo do të siguronte një të ardhme të qëndrueshme”.

Diaspora na mëson



znj. Manoela Lussi, Menaxhere e Programit të IOM Albania u shpreh shumë optimiste për ecurinë e këtij projekti, duke theksuar gjithashtu potencialin e Diasporës shqiptare në bujqësi, turizëm dhe në sipërmarrje. “Si pjesë e Programit të Diasporës ne kemi punuar me 8 shoqata nga diaspora shqiptare, OJQ në Itali dhe Shqipëri përmes katër projekteve të fokusuara në zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit. Ne besojmë se projekte të ngjashme krijojnë mundësi të reja ekonomike për zonat rurale, prodhuesit bujqësorë dhe fermerët duke optimizuar prodhimin dhe proceset e lidhura me punën, duke rritur njohuritë teknike të fermerëve dhe duke shkëmbyer praktikat më të mira midis kontekstit italian dhe atij shqiptar”

znj. Gerarta Ballo, përfaqësuese e Shoqatës së Kultivuesve Italinë (AIC) vlerësoi bashkëpunimet dhe shkëmbimin e ideve që solli ky projekt: “Ky është një projekt që e kemi trajtuar me shumë dëshirë, pasi lidhet me ndjenjat që Diaspora ka për vendlindjen. Për organizatën dhe për ne ishte një dëshirë shumë e madhe të realizonim një projekt me Shqipërinë, nëpërmjet programit të IOM Albania. Ky program do vijojë dhe shpresoj që të kemi sa më shumë bashkëpunime dhe shkëmbime idesh.”



Diaspora
na mëson



Dr. Elisabeta Katiaj, Mentore e projektit u shpreh se ky është një projekt për t'u vlerësuar, por gjithashtu duhet të ketë vijimësi: "Ka qenë një kënaqësi të isha pjesë e këtij projekti, edhe për mua është një eksperiencë shumë e bukur për të bashkëpunuar dhe për të njohur fermerët shqiptarë, të cilët ushtrojnë aktivitetin jo pa vështirësi. Një problem që hasëm ishte certifikimi i produkteve, kështu ne mundësuam kontakte me certifikues nga Italia, të cilët mund të ofrojnë shërbimin e certifikimit edhe ne Shqipëri. Problematikat në sektorin e bujqësisë janë të shumta por mbetemi optimistë pasi prodhimi i produkteve mjaft cilësore nga njëra ane dhe gatishmëria e fermerëve të përqafojnë ekspertizat dhe praktikat e testuara nga diaspora nga ana tjetër janë treguesit të zhvillimit të qëndrueshëm të këtij sektori. Ky projekt përfaqëson një ndihmë konkrete në aftësimin profesional dhe rritjen e kompetencës së fermerëve".

z. Luciano Guglielmetti, Përgjegjës teknik i Qendrës së Asistencës Bujqësore pranë AIC solli përvojën e organizatës per perfshirjen sociale te zonave rurale duke u fokusuar në një mori karakteristikash rurale të Italisë, në veçanti asaj të jugut me atë Shqiptare duke fillura me segmentimin e tokës, vetepunesimin ne bujqësi, nevojat për mekanikë bujqësore dhe trajnime të fermereve, mungesa të studimit të tregut të produkteve etj. z. Guglielmetti permendi rezultatet pozitive dhe të qëndrueshme të siguruara nga projekte të ndryshme qe AIC kish ndërmarrë si orientimi i prodhimit bujqësor, krijimi i indeksit të produkteve bujqësore, organizimi i tregjeve rajonale, standartizimi dhe certifikimi GAP, organizimi në kooperativa.



Diaspora na mëson



Në fjalën e tij z. Giovanni Lattanzi, Drejtor i Raporteve Institucionale pranë AIC theksoi ndër të tjera se iniciativat e organizatave ne tërheqjen e investimeve qeveritare apo komunitare drejt përmirësimit dhe shtrirjes territoriale te infrastrukturave publike, aksesi i plotë në arsim dhe shendetesi, trajnimet profesionale dhe trajnimet në fushën e marketingut bujqesor janë aktivitete të nje rëndësie vendimtare per ruajtjen e territoreve rurale, zhvillimin e qëndrueshëm të tyre për të shmangur degradimin territorial me ndikim negatin në ndryshimet klimaterike. Mbrojtja e mjedisit eshtë një nga elementët shtesë në perfshirjen sociale te zonave rurale.



Pjesë e rëndësishme e konferencës ishte prezantimi i Ermir Hylviut, fermer i ri në kultivimin e shegës të varietetit Jolly Red (Rrogozhinë) dhe Kejda Musa, menaxhere e marketingut të kompanisë “Musai Olive Oil” në Vlorë, të cilët sollën përvojat personale të fituar nga zbatimi i projektit si dhe të rejat që ata mësuan gjatë trajnimeve në terren nga ekspertët arbëreshë.



Eksperti i Politikave Bujqësore Dr. Ilir Pilku, vlerësoi arritjet dhe materialet e gjeneruara nga zbatimi i projektit nga DHBD-ës si një kontribut të vyer të diasporës dhe ekspertëve arbëreshe e Italiane në aftësimin dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të fermerëve shqiptarë. Gjithashtu ai ndau me te pranishmit informacionin rreth angazhimit të të gjithë aktorëve të sektorit të bujqësisë shqiptare në krijimin e indeksit kombëtar të produkteve bujqësore.

Diaspora na mëson

DHOMA E BIZNESIT
TË DIASPORËS SHQIPTARE

AIC
Associazione Italiana Coltivatori

IOM
UN MIGRATION

Angazhimi i Diasporës në transferimin e njohurive bujqësore në Shqipëri

KONFERENCË

"Përfshirja sociale në zhvillimin rural"

E mërkurë, 29 shtator 2021

Materiali i prezantuar nga Drejtori Ekzekutiv
i Dhomës së Biznesit të Diasporës
z. Durim Tabaku

Qëllimi dhe objektivat e Projektit

Qëllimi

- Të mbështesë rritjen socio-ekonomike të zonave rurale shqiptare duke përmirësuar kapacitetin e NVM-ve bujqësore për të bashkëpunuar me Diasporën Shqiptare në Itali duke ofruar kështu një kontribut të prekshëm në rritjen e njohurive, kapaciteteve dhe kompetencave përmes transferimit të njohurive.


Objektivat


- Rritja e aftësive të fermerëve shqiptarë përmes ofrimit të shërbimeve dhe njohurive - mënyra e transferimit nga diaspora shqiptare në Itali
- Rritja e angazhimit të diasporës në zhvillimin lokal përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të praktikave të mira


Projekti në shifra (1)


Shtrirja
- Tiranë; Durrës; Kavajë; Cërrik; Rrogozhinë; Vlorë.

Platformë
- www.diasporanameson.al me mbi 7,000 vizitorë









Projekti në shifra (2)

3 Workshope
- për aksesin e kompanive shqiptare në tregjet ndërkombëtare (kryesisht evropiane)

4 Module
- trajnimi të prezantuara në seminare me pjesëmarrje të gjerë, kryesisht biznese të fushës, të rinj të interesuar, fermerë dhe sipërmarrës bujqësorë nga zonat e projektit dhe më gjerë



Projekti në shifra (3)

4 ditë të plota demonstrime në terren

- Me ekspertë të njohur të diasporës shqiptare në Itali me Dr. Salvatore Armentano në Marikaj dhe Vlorë me kultivues të ullirit dhe prodhues të vajit të ullirit dhe Dr. Loriano Dalle Norega në Cërrik dhe Rrogozhinë me kultivues të fruta-perimeve.

Marikaj, Tiranë







Skrofotinë, Vlorë







Cërrik





Rrogozhinë





Projekti në shifra (4)

5 broshura dhe publikime të tjera

- për kultivimin e ullirit, hudhrës, shegës, standardet e BE-së dhe informacione të ndryshme e të larmishme për certifikimin BIO me qëllim eksportimin në vendet e BE-së.



12 kompani përfituese të drejtpërdrejtë

- 6 kompani prodhim vaj ulliri dhe 6 kompani kultivuese e eksportuese të fruta perimeve; prodhues vere, etj.



Mbi 600 fermerë përfitues

- përfitues indirekt të projektit, kryesisht fermerë që merren me kultivimin e ullirit, punonjës sezonale të bujqësisë, fermerë kultivues të frutave dhe perimeve për tregun vendas

Çështje për projekte të mëtejshme

Trajnim i fuqisë punëtore

- Veçanërisht në procese bujqësore gjatë periudhës së mbjelljeve dhe korrjeve të produkteve – vjelja e ullirit pa rënë në tokë, p.sh.,
- Trajnim i fuqisë punëtore dhe investime të vogla por të domosdoshme në bujqësi për të siguruar produkte cilësore për përpunim bio

Futja e metodave bashkëkohore

- Prezantim i teknikave më të fundit për proceset në bujqësi me qëllim uljen e kostove, rritjen e cilësisë së kulturave të kultivuara, ruajtjen e cilësisë së tyre bio, pakësimin e përdorimit të kimikateve që dëmtojnë cilësinë bio, etj.

Nxitja e të rinjve për bujqësi

- Mungesa e fuqisë punëtore në bujqësi bën të domosdoshme hartimin e programeve për nxitjen e të rinjve në angazhimin dhe rikthimin e tyre në bujqësi/fshat, për sipërmarrje bujqësore, etj.

Planet e DHBD për të ardhmen

Projekte për zhvillimin bujqësor

- Kualifikimi i fuqisë punëtore
- Prezantimi i metodave bashkëkohore në proceset bujqësore, duke u mbështetur në përvojën e diasporës
- Nxitja e të rinjve për angazhim në bujqësi
- Promovimi i grave në zhvillimin bujqësor dhe rural

Nxitja e investimeve në bujqësi nga Diaspora

- Ndërtimi i fabrikave për përpunimin e produkteve bujqësore (me plane për në Korçë, Tiranë, etj.);
- Sjellja e përvojës së Diasporës në zhvillimin rural, veçanërisht nga vendet fqinje, si Italia e Greqia;
- Asistenca në hartimin e politikave stimuluese për nxitjen e investimeve të Diasporës në bujqësi;
- Bashkërendimi me planet e qeverisë qendrore dhe bashkive për investimet në bujqësi, etj.
- Projekti «Fluturo me shqipen»

DHOMA E BIZNESIT
TË DIASPORËS SHQIPTARE

AIC
Associazione Italiana Coltivatori

IOM
UN MIGRATION

Angazhimi i Diasporës në transferimin e njohurive bujqësore në Shqipëri

KONFERENCË
"Përfshirja sociale në zhvillimin rural"

E mërkurë, 29 shtator 2021

Materiali i prezantuar nga
Eksperti i Politikave Bujqësore
Dr. Ilir Pilku

Prezantim



“Zhvillimi Bujqësor dhe Përfshirja Sociale”

Ilir Pilku

Ekspert i Politikave Bujqesore

Bujqësia ne Shqiperi paraqet një **potencial** të lartë **rritjeje**


- 50% e popullsisë jeton në zona rurale;
- Afërsi me tregjet Evropiane;
- Tokë e mirë dhe kushte klimaterike të favorshme;
- Forcë pune relativisht e arsimuar;
- Kosto pune të ulëta;
- Fermerët në përgjithësi janë të orientuar ndaj biznesit;
- Disponilitet grantesh per investime.



Financimi dhe Investimet e reja – Oportunitete per rritje


42-47%

Punesimi ne Bujqesi




20%

Eshte **kontributi** i bujqesise ne **GDP**



1.5-2%

Eshte aktualisht **Financimi i Bujqesise**



Punesimi ne Bujqesi

Vendet	Përpjesa (%)
Shqipëri	43.15
Maqedonia veriore	17.71
Kroacia	11.12
Sllovenia	7.88

Viti	Të punësuar gjithsej	Sektori privat bujqësor	Sektori bujqësor ndaj vitit 2000
2000	1068190	761000	1
2001	920569	526337	0.691639
2010	904364	496190	0.652024
2017	1095881	456523	0.599899
2018	1137939	459778	0.604176
2019	1147131	460878	0.605622



Në vitin 2019, **importet** e produkteve bujqësore arritën në rreth **€900 milion**.
Eksportet kanë vazhduar të rriten, duke arritur në **rreth €290 mili**onë në 2019, një rritje prej 10% nga 2017.



Potenciali i Jashtem

Kerkesa konstante te tregut Evropian dhe Boteror per produkte Shqiptare.

Krahasuar me vitin 2010, rritja e eksporteve eshte **3.8 here.**

Evidenca nga Panaire Nderkombetare dhe Rajonale.



Potenciali i Brendshem


Balanca Tregtare per produktet ushqimore

Export - Import:

2010 **1:8.9**

2019 **1:3.2**





BALANCA TREGTARE NE ZINXHIRIN BUJQESOR
1000
500
0
-500
-1000
2005
2006
2007
2008
2009
2010
2011
2012
2013
2014
2015
2016
2017
2018
2019
Export
Import
Deficiti Tregtar

Sfida: Bujqesia 2.7

EU eshte destinacioni i Bujqesise Shqiptare


IPARD-3: **€146** Buxheti ne forme Granti (2021-2027)

Hendeku i Financimit të Sektorit Bujqesor perllogaritet rreth **€600 milion**



Potencialitetin Ekonomik BUJQESOR

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik



HARTA BUJQËSORE


QARKU
SHKODËR

Megjithatë rajonizimi i foragjereve do të ndjeke
të të rajonizimit të gjedhit.

AKTIVITETET BUJQËSORE

- BIMËT E ARAVE
  - * MISËR
  - * BIMË MEDICINALE
- PEMËT FRUTORE
  - * ARRORË
  - * VRESHTA
- BLEGTORIA
  - * LOPË
  - * TE IMTA
  - * DERRA
  - * BLETË

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik




HARTA BUJQËSORE

QARKU
KUKËS

AKTIVITETET BUJQËSORE

- BIMËT E ARAVE
  - * PATATE
  - * BIMË MEDICINALE
- PEMËT FRUTORE
  - * ARRORË
  - * KUMBULLA
- BLEGTORIA
  - * BAGËTI TË IMTA
  - * BLETË

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik



HARTA BUJQËSORE

QARKU
LEZHË

AKTIVITETET BUJQËSORE

- BIMËT E ARAVE
  - * MISËR
- PEMËT FRUTORE
  - * SHEGË
  - * VRESHTARI
- BLEGTORIA
  - * DERRI

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik




HARTA BUJQËSORE

QARKU DIBËR

AKTIVITETET BUJQËSORE

- **BIMËT E ARAVE**
  - * PATATE
  - * BIME MEDICINALE
- **PEMËT FRUTORE**
  - * MOLLË
  - * KUMBULL
  - * QERSHI
- **BLEGTORIA**
  - * BAGËTI TË IMTA

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik



HARTA BUJQËSORE

QARKU
DURRËS

AKTIVITETET BUJQËSORE

- BIMËT E ARAVE
  - * PERIME NË SERË
- PEMËT FRUTORE
  - * SHEGË
  - * KIWI
  - * VRESHTARI
- BLEGTORIA
  - * LOPË

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik



HARTA BUJQËSORE

QARKU TIRANË

AKTIVITETET BUJQËSORE

- BIMËT E ARAVE
  - * PERIME
  - * BIMË MEDICINALE
- PEMËT FRUTORE
  - * PJESHKË
  - * VRESHTARI
  - * ULLISHTARI
- BLEGTORIA
  - * LOPË

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik



HARTA BUJQËSORE

QARKU ELBASAN

AKTIVITETET BUJQËSORE

- BIMËT E ARAVE
  - DUHAN
  - PERIME NE SERRA
  - BIME MEDICINALE
- PEMËT FRUTORE
  - QERSHI
  - KIWI
  - SHEGË
  - ULLISHTARI
- BLEGTORIA
  - LOPË
  - BAGËTI TË IMTA



Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik



HARTA BUJQËSORE

QARKU
FIER

AKTIVITETET BUJQËSORE

- BIMËT E ARAVE
  - * MISËR
  - * PERIME NË SERË
  - * PERIME NE FUSHE
- PEMËT FRUTORE
  - * SHEGË
  - * KIWI
  - * LULESHTRYDHE
  - * ULLISHTARI
  - * BOSTANORE
- BLEGTORIA
  - * LOPË

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik



HARTA BUJQËSORE

QARKU
BERAT

AKTIVITETET BUJQËSORE

- BIMËT E ARAVE
  - PERIME NË SERË
- PEMËT FRUTORE
  - QERSHI
  - VRESHTARI
  - SHEGË
  - ULLISHTARI
  - BOSTANORE
- BLEGTORIA
  - BLETË
  - LOPE

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik



HARTA BUJQËSORE

QARKU KORÇË

AKTIVITETET BUJQËSORE

- BIMËT E ARAVE
  - FASULE
  - PATATE
  - BIME MEDICINALE
  - Qepe
- PEMËT FRUTORE
  - MOLLË
  - QERSHI
  - ARRORE
- BLEGTORIA
  - LOPË
  - BAGËTI TË IMTA
  - BLETË

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik



HARTA BUJQËSORE

QARKU
GJIROKASTËR

AKTIVITETET BUJQËSORE

BIMËT E ARAVE
* BIMË MEDICINALE
* MISER

BLEGTORIA
* BAGËTI TË IMTA
* BLETË

Tipologjia e fermave bazuar ne potencialitetin ekonomik



HARTA BUJQËSORE

QARKU VLORË

AKTIVITETET BUJQËSORE

- **PEMËT FRUTORE**
  - ULLISHTARI
  - AGRUMET
- **BLEGTORIA**
  - BAGËTI TË IMTA
  - BLETË